



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Ftesë për Ofertë

Data: 31 Korrik 2026

Titulli: Thirrje për Ofertë nga Individë/OJQ/Kompani për realizimin e dokumentarit për RrGK-në

Të nderuar,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) fton individë, OJQ dhe kompani me përvojë në prodhim audiovizual të paraqesin ofertat e tyre për realizimin e një dokumentari deri në 20 minuta, me rastin e 30-vjetorit të themelimit të RrGK.

Dokumentari do të dokumentojë historinë, zhvillimin, arritjet dhe ndikimin e RrGK-së në avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Kosovë. Realizimi i dokumentarit është planifikuar të fillojë më **25 gusht 2026** dhe të përfundojë jo më vonë se **30 nëntor 2026**.

Ju ftojmë të paraqisni ofertën tuaj në përputhje me dosjen e tenderit të bashkëngjitur. Oferta duhet të përmbajë:

- Formularin e Propozimit Teknik (Forma 5.1);
- Ofertën Financiare (Forma 5.2);
- Letrën e motivimit dhe Deklaratën e Nderit (Forma 4);
- Portofofin e punëve të realizuara ndër vite, duke përfshirë përvojën në realizimin e dokumentarëve (nëse ka), si dhe një (1) deri në tre (3) shembuj të punëve të mëparshme të ngjashme (dokumentarë);
- CV-të e stafit kryesor të propozuar për angazhim në realizimin e dokumentarit (përfshirë, sipas nevojës, producentin, regjisorin, skenaristin, kameramanin dhe/ose montazherin), të cilat dëshmojnë përvojën dhe kompetencat profesionale relevante për këtë angazhim.

Ju lutem, dërgoni ofertën tuaj në: procurement@womensnetwork.org me titull: "Ofertë për realizimin e dokumentarit."

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 21 Gusht 2026, ora 17:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren parasysh.

Ju faleminderit për interesimin dhe bashkëpunimin!